

# Programi i Kryesimit suedez të OSBE-së

# 2021

# Parathënie

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ka një trashëgimi për t'u krenuar. Fakti që një numër kaq i madh i shteteve ishin në gjendje të bëheshin bashkë në një kohë antagonizmesh e mosmarrëveshjesh botërore dhe të njësonin një sërë parimesh e angazhimesh të përbashkëta është një arritje historike. Është pikërisht kjo ajo çfarë ne, shtetet pjesëmarrëse, duke filluar që nga Vankuveri e deri në Vladivostok, ishim në gjendje të arrinim me miratimin e Aktit final të Helsinkit në 1975. Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, arritëm t'i thellojmë dhe forcojmë edhe më zotimet tona të përbashkëta përmes Kartës së Parisit për një Evropë të Re.

Sot ne jetojmë në një botë ndryshe në shumë aspekte, ndërsa konfliktet dhe krizat politike vazhdojnë të sfidojnë sigurinë tonë të përbashkët, parimet demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Njëkohësisht, kërcënimet transnacionale, përfshirë terrorizmin, krimin kibernetik dhe degradimin e mjedisit, janë shtuar. Gjithashtu, pandemia COVID-19 është kthyer në një barrë shtesë në shoqëritë tona.

Emëruesi i përbashkët i gjithë këtyre sfidave është sa vijon: ato mund të zgjidhen vetëm në mënyrë të qëndrueshme përmes bashkëpunimit ndërkombëtar. Kështu, një platformë shumëpalëshe, siç është OSBE-ja, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Tanimë ka ardhur koha që t'i "kthehemi çështjeve



**Kryesuesja e Radhës, Ministria e Punëve të Jashtme, Ann Linde.**

Foto: Kristian Pohl/Regeringskansliet

themelore” dhe t’ia kujtojmë vetes rregullat dhe mjetet që kemi krijuar për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet dhe krizat, si dhe ta jetësojmë sigurinë si për njerëzit ashtu edhe për shtetet. Si kryesuese, Suedia do të vë theksin mbi detyrat themelore të OSBE-së siç janë rendi i sigurisë në Evropë dhe koncepti gjithëpërfshirës i OSBE-së për sigurinë dhe për të kontribuar në zgjidhjen e konflikteve.

Suedia përpiqet të jetë një shtet pjesëmarrës aktiv dhe konstruktiv i OSBE-së. Dëshirojmë që t’i ngrisim disa çështje në të cilat mund të punojmë së bashku me qëllimin që OSBE-në ta përminësojmë edhe më shumë: që barazia gjinore ndihmon në

zhvillimin e shoqërive përparimtare e me aftësi rimëkëmbjeje, që pjesëmarrja e grave në zgjidhje të konflikteve çon në paqe më të qëndrueshme, dhe që respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit, promovon sigurinë dhe hedh themelet për rritje ekonomike

Kam nderin që të marr përsipër kryesimin e kësaj organizate jetike për vitin 2021. Synimi im është që si organizatë t’ia kujtojmë vetes gurthemelet që i kemi krijuar dhe mbi të cilat mund të vazhdojmë së ndërtuari të ardhmen tonë me forca të bashkuara. **Fundja, është fjala për zotimet tona dhe sigurinë jonë. Është OSBE-ja jonë.**

# Kthim tek çështjet themelore

Pjesa jonë e botës po përballlet me sfida të mëdha. E drejta ndërkombëtare po shkelet, akoma ka shumë konflikte të pazgjidhura me shpërthime dhune ose agresion të vazhdueshëm, ndërsa detyrimet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut, parimet e demokracisë dhe sundimin e ligjit po vihen në pikëpyetje gjithnjë e më shumë. Ndryshimet klimatike paraqesin një tjetër kërcënim gjithnjë në rritje, e përparimi në barazinë gjinore është i ngadaltë dhe jo i njëtrajtshëm. Në të njëjtën kohë, ne kemi në dispozicion organizatën më të madhe rajonale të sigurisë në botë, të ndërtuar mbi angazhime e parime që, po të zbatohen, mund të sjellin paqe dhe stabilitet në rajonin tonë.

Suedia shpreson të jetë në krye të orvatjeve tona të përbashkëta në kuadër të OSBE-së në vitin 2021. Si kryesuese e OSBE-së, fokusi kryesor i Suedisë do të jetë kthimi tek çështjet themelore. Theksi do vihet në detyrat themelore të OSBE-së: mbrojtja e rendit evropian të sigurisë, mbështetja e konceptit gjithëpërfshirës të sigurisë të OSBE-së dhe dhënia e kontributit në zgjidhjen e konflikteve në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.



Populli suedez gëzon të drejtën për të marrë pjesë në demonstrata, për liri të shprehjes, për medie të lira, mundësinë për të lëvizur lirshëm në natyrë dhe të drejtën për të kërkuar llogari nga ata që janë në pushtet. Kjo liri ka të bëjë me krijimin e një shoqërie të barabartë. E Premtja për të Ardhmen është një lëvizje që filloi në gusht të vitit 2018, kur atëbotë 15-vjeçja Greta Thunberg u ul para parlamentit Suedez çdo ditë shkolle për tre javë rresht, për të protestuar kundër mosveprimit karshi krizës klimatike. Foto: Jann Lipka/imagebank.sweden.se

# Një botë ku respektohen rregullat e përbashkëta është një botë më e sigurt



Dekalogu i Aktit final të Helsinkit të vitit 1975, angazhimet e përcaktuara me Kartën e Parisit të vitit 1990, bashkë me të gjitha parimet dhe angazhimet e tjera të OSBE-së, përbëjnë gurthemelin e rendit evropian të sigurisë. Ato janë parimet udhëzuese të cilat ne, si shtete pjesëmarrëse, jemi zotuar bashkërisht që t'i respektojmë. Barazia mes shteteve, përmbajtja nga kërcënimet ose përdorimi i forcës, respektimi i integritetit territorial dhe liria e shteteve për të zgjedhur mënyrat si ta rregullojnë sigurinë në vend, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, janë ca nga këto parime themelore të së drejtës ndërkombëtare. Natyrisht, në bosht të tyre qëndron Karta e Kombeve të Bashkuara.

Dhjetë vjet më parë, e rikonfirmuam zotimin tonë në Deklaratën Përkujtimore të Astanës. Është në interes të të gjithë rajonit të OSBE-së dhe popujve të tij që ne t'i nderojmë zotimet e bëra. Ato janë arritja jonë e përbashkët dhe çështje me interes të menjëhershëm dhe legjitim për të

gjitha shtetet pjesëmarrëse. Një botë ku këto zotime respektohen është një botë më e sigurt.

Gjatë Kryesimit suedez të OSBE-së, këto parime do të përbëjnë thelbin e përpjekjeve tona. Ata do t'i orientojnë aktivitetet tona në terren, përcaktimin e agjendës tonë në Këshillin e Përhershëm, si dhe qasjen tonë ndaj zgjidhjes së konflikteve të formave ku është e angazhuar Kryesuesja e OSBE. Llogaridhënia politike është pjesë e rëndësishme e punës së OSBE-së.

# Siguria njerëzore - ndërlidhja e pazgjidhshme midis sigurisë së shteteve dhe sigurisë së qytetarëve


Marrëdhëniet midis shteteve janë vetëm një aspekt i sigurisë: njësoj të rëndësishëm për njerëzit në jetën e tyre të përditshme janë faktorët si siguria politike, gëzimi i plotë i të drejtave të njeriut, demokracia, sundimi i ligjit, si dhe siguria ekonomike dhe mjedisore. Këta faktorë janë që të gjithë parakushte për shoqëri të sigurtat e të qëndrueshme, që për rrjedhojë krijojnë siguri më të madhe mes shteteve. Koncepti gjithëpërfshirës i sigurisë i OSBE-së e ka parasysh këtë gjë. Gjatë viteve të shkuara parimet demokratike dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë sfiduar gjithnjë e më shumë në rajonin tonë, ndërsa pandemia e Covid-19 vetëm se ka shtuar rrezikun e prapambetjes së mëtejshme.

E drejta për lirinë e mendimit dhe shprehjes dhe liria e mediave janë elementet kryesore të konceptit gjithëpërfshirës të sigurisë të OSBE-së dhe do të jenë prioritete qendrore në dimensionin njerëzor. Gjatë Kryesimit suedez të OSBE-së, ne do të nënvizojmë po ashtu dhe proceset demokratike, hapësirën dhe pjesëmarrjen qytetare si strumbullar i ruajtjes dhe promovimit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, demokracisë dhe

sundimit të ligjit. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, një rol të rëndësishëm kanë aktorët e shoqërisë civile. Çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe barazinë gjinore do të përfshihen si pjesë përbërëse e agjendës.

Përpjekjet tona do të jenë në mbështetje të dhe do të përplotësojnë punën e rëndësishme të bërë nga institucionet autonome, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Përfaqësuesi për Lirinë e Medias dhe Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare. Puna e tyre është jetike për t'u ndihmuar shteteve pjesëmarrëse në respektimin dhe zbatimin e zotimeve dhe parimeve të OSBE-së, përforcimin dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe parandalimin e konflikteve nëpërmjet mbështetjes së demokracisë dhe mediave të lira dhe të pavarura dhe Zbutjes së tensioneve që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

Kodi i sjelljes mbi aspektet politiko-ushtarake të sigurisë do t'i drejtojë përpjekjet e Kryesueses për të vënë në pah rëndësinë e sigurimit të kontrollit demokratik civil mbi forcat e armatosura.





**Vëzhguesit e zgjedhjeve gjatë zgjedhjeve presidenciale në Maqedoninë e Veriut, Shkup, 5 maj 2019.**

Foto: OSCE/ Maria Kökçe

# Përprojekjet për t'i zgjidhur konfliktet duhet të përshpejtohen, instrumentet për ngritjen e besimit dhe parandalimin e konflikteve janë në dispozicion për t'u përdorur

Kontributi për zgjidhjen e konflikteve në rajonin e OSBE-së mbi bazat e parimeve dhe zotimeve tona të dakorduara bashkërisht do të jetë në krye të agjendës sonë. Në shërbim të këtij qëllimi, kryesuesja suedeze do të mbështesë aktivisht format dhe proceset ekzistuese të OSBE-së për zgjidhje të konflikteve, përfshirë përmes përfaqësuesve të veçantë të Kryesueses së Radhës. Ne do t'i promovojmë operacionet unike të OSBE-së në terren. Kontributet e tyre thelbësore do të mbështeten dhe nënvizohen gjatë vizitave në terren nga Kryesuesja e Radhës.

Ndër konfliktet në rajonin e OSBE-së, konflikti në dhe përreth Ukrainës mbetet sfida më e dukshme ndaj rendit evropian të sigurisë. Si kryesuese, Suedia e njuh rëndësinë jetike që ka Misionit i Posaçëm Monitorues në Ukrainë dhe do të mëtoj të kontribuojë në përprojekjet e vazhdueshme në kuadër të Formatit të Normandisë dhe Grupit të Kontaktit Trilpalësh për një zgjidhje politike të qëndrueshme në pajtim me parimet dhe angazhimet e OSBE-së, duke respektuar në tërësi sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht.

Ngjashëm, ne do të luajmë një rol aktiv në Diskutimet Ndërkombëtare të Gjenevës dhe Mekanizmin gjegjës për parandalim dhe reagim ndaj incidenteve (MPRI) në lidhje me Gjeorgjinë, si edhe në mbështetje të procesit të arritjes së ujdisë lidhur me Transnistriinë.

Si kryesuese dhe anëtare e përhershme e Grupit të Minskut, Suedia do të mbështesë po ashtu dhe përprojekjet e Bashkëkryesuesve të Grupit të Minskut për të zgjidhur konfliktin e Nago-Karabakut. Shpërthimi i konfliktit të armatosur vitin e kaluar, numri i lartë i vdekjeve dhe vuajtjet e njerëzve kanë nënvizuar rrezikun e qenësishëm që mund të paraqesin konfliktet e stërzgjatura të pazgjidhura në rajonin e OSBE-së.

Kanë kaluar dhjetë vjet që nga vendimi në Vilnius për "elementet e ciklit të konfliktit". 2021-ta shënon një mundësi për t'i rishikuar mjetet ekzistuese për parandalim dhe zgjidhje të konflikteve.

Në të gjitha konfliktet e armatosura, ne do të bëjmë thirrje për respektimin e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare.



Ne do të mbështesim masat për t'i zbutur pasojat humanitare dhe do të avokojmë për një qasje gjithëpërfshirëse. Zotimi i fuqishëm shumëpalësh i Suedisë do të përkthehet në bashkëpunim të shtuar ndërmjet OKB-së dhe OSBE-së, si edhe ndërmjet BE-së dhe OSBE-së, dhe atë jo vetëm në parandalim dhe adresim të konflikteve. Ne do të kërkojmë bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Suedia do të punojë vazhdimisht për ta mbështetur konceptin gjithëpërfshirës të OSBE-së të sigurisë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen kuptimplote të grave e burrave në përpjekjet për t'i adresuar të gjitha fazat e ciklit të konfliktit, si dhe për të zbatuar Agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Një gjë e tillë është vendimtare për parandalimin dhe zbutjen me sukses të konflikteve, si dhe për të konsoliduar paqen pasi të kenë mbaruar luftimet.

Suedia do të mbështesë përpjekjet në kuadër të Forumin për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë (FBFS), për të siguruar që besimi dhe masat për ngritjen e sigurisë të vazhdojnë së

konsideruari të rëndësishme, përfshirë edhe në situatën aktuale kur ato janë duke u sfiduar. Njëlloj sikur që OSBE-ja mund të jetë efektive vetëm kur të gjithë veprojnë me mirëbesim në përputhje me rendin evropian të sigurisë, masat për ngritjen e besimit dhe sigurisë (MNBS) do të funksionojnë ashtu siç janë paraparë vetëm atëherë kur palët nënshkruese të traktate respektojnë dispozitat e dhe frymën në të cilën janë hartuar ato. Si kryesuese, Suedia do të përpiqet të mbështesë rolin e rëndësishëm të Traktatit të Qiejve të Hapur, funksion i rëndësishëm ky i MNBS.

MNBS-të duhet po ashtu t'u përshtaten ndryshimeve të rrethanave. Si kryesues, ne do të vazhdojmë të mbështesim diskutimet lidhur me propozimin për modernizimin e Dokumentit të Vjenës me qëllim të rritjes së transparencës dhe parashikueshmërisë, si dhe forcimit të besimit midis shteteve për çështjet ushtarake. Ne e shohim Dialogun e Strukturuar si një platformë me rëndësi për dhënie të kontributit në këto diskutime.



**Pjesëmarrësit gjatë seancës hapëse të Këshillit të 25-të të Ministrave të OSBE-së, të mbajtur në Milano më 6 dhjetor 2018. Foto: ANSA/FLAVIO LO SCALZO**

# Përfshirja e gjithë popullsisë - zbatimi i Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë dhe të drejtat e barabarta janë me interes jetik për sigurinë

Njëzet vjet pas miratimit të Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) dhe rezolutave gjegjëse pasuese, gratë janë akoma shumë pak përfaqësuar në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit, ndërsa ndikimi i konfliktit tek gratë, burrat, vajzat dhe djemtë shpesh nuk njihet plotësisht. Kjo vlen edhe për rajonin e OSBE-së.

Gjatë Kryesimit suedez të OSBE-së, ne do të priorizojmë zbatimin e Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Do të punojmë për ta forcuar OSBE-në në prodhimin e të dhënave, analizave dhe veprimeve, dhe jo vetëm ato të lidhura me konfliktet, që trajtojnë çështjet gjinore. Gjatë vizitave në operacionet në terren, Kryesuesja e Radhës do t'i kushtojë vëmendje të veçantë punës së tyre të rëndësishme në këtë drejtim, si dhe organizatave për të drejtat e grave në terren.

Shoqëritë ku ka barazi gjinore, ku të drejtat e njeriut gëzohen plotësisht nga të gjithë pa dallim, janë më të sigurta dhe me perspektivë më të mirë për një zhvillim të qëndrueshëm e përparimtar. Gratë u ekspozohen në mënyrë disproporcionale çënueshmërive ekonomike dhe të sigurisë që është rrjedhojë e pjesëmarrjes së barabartë në jetën ekonomike. Fuqizimi ekonomik është i nevojshëm për mundësimin dhe arritjen e pjesëmarrjes së plotë dhe efektive politike të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

Suedia do të vazhdojë me punën në dimension të dytë me këtë çështje si prioritet me rëndësi. Ne do të përqendrohemi në fuqizimin ekonomik dhe pjesëmarrjen kuptimplotë të grave, duke u bazuar në vendimin që u mor në Vilnius në vitin 2011.



# Ndërtimi i shoqërive të qëndrueshme dhe më të forta për t'iu kundërvënë kërcënimeve ndaj sigurisë njerëzore

Kërcënimet ndaj sigurisë sonë nuk janë vetëm të natyrës ushtarake, as medoemos të lidhura me konfliktet midis shteteve. Për t'i luftuar kërcënimet nga krimi i organizuar, terrorizmi, kërcënimet kibernetike dhe shkatërrimi i mjedisit, ne duhet të vazhdojmë së ndërtuari shoqëri të qëndrueshme e të forta. Në të njëjtën mënyrë, korrupsioni është një kërcënim që minon shoqëritë tona. Ai ushqen krimin e organizuar dhe kërcënon sistematikisht zhvillimin e qëndrueshëm, demokracinë dhe sigurinë. Suedia do të vazhdojë punën e kryesimeve të mëparshme për luftimin e korrupsionit dhe forcimin e qeverisjes së mirë. Duke përmirësuar demokracinë, respektimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut dhe sundimin e ligjit, shoqëritë mund të bëhen më të sigurta.

Kryesimi suedez do të vë theksin mbi ndërlidhjet midis çështjeve kibernetike, sigurisë dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ne do të synojmë të ecim tutje me zbatimin e masave për ngritjen e besimit në fushën kibernetike.

Ndryshimet klimatike dhe degradimi natyror prekin miliona gra, burra, vajza e djem në mbarë botën dhe në rajonin e OSBE-së. Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje ndërlidhjes mes ndryshimeve klimatike dhe sigurisë. Përpjekjet për parandalimi dhe ndërtim të paqes duhet të marrin në konsideratë ndryshimet klimatike, gjersa përpjekjet për t'i luftuar ndryshimet klimatike të realizohen me ndjeshmëri ndaj konfliktit. Veç kësaj, bashkëpunimi për çështje mjedisore mund të sjellë rezultate pozitive përtej përmirësimit të mjedisit lokal. Si kryesues, ne do të vazhdojmë rolin aktiv të OSBE-së në parandalimin dhe përballimin e sfidave të sigurisë mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike.



**Kapitenia Anna Björsson duke folur në një takim të përbashkët të Forumit për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë dhe të Këshillit të Përhershëm.** Foto: OSBE / Micky Kroell.



**Ministria e Jashtme Ann Linde si Kryesuesja e ardhshme pranë urës mbi vijën e kontaktit në Stanytsia Luhanska në Ukrainën lindore, 3 Mars 2020.** Foto: Ministria e Punëve të Jashtme/Johannes Danielsson.

# Rreth nesh - Kryesimi suedez për vitin 2021

Kryesimi ynë nuk ka të bëjë vetëm me atë që arrijmë, por edhe se si e realizojmë atë. Suedia do të përpiqet të punojë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse dhe duke shfrytëzuar burimet në mënyrë sa më efikase që të jetë e mundshme. Ne dëshirojmë të shohim pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile, instituteve dhe institucioneve kërkimore. Ato mund të ofrojnë këndvështrime të rëndësishme, të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta dhe të lehtësojnë dialogun dhe bashkëpunimin joformal që mbështesin përpjekjet tona politike. Ne do të përpiqemi të jemi të arritshëm, ekonomikë dhe konkret. Kjo ka të bëjë gjithashtu me demokracinë e legjitimitetin - kryesimi i organizatës duhet të jetë një qëllim i arritshëm për që të 57 shtetet pjesëmarrëse.

Në një epokë kur siguria jonë po sfidohet nga kërcënime gjithnjë e më komplekse, shansi ynë për të bërë një ndryshim të vërtetë qëndron në dialog, bashkëpunim, gjithëpërfshirje dhe respektim të parimeve të rëna dakord. Duke iu përmbajtur zotimeve tonave në të mirë të sigurisë sonë të përbashkët, ne mund të sigurojmë që OSBE-ja të bëjë ndryshimin.

**ZOTIMET TONA.  
SIGURIA JONË.  
OSBE-ja JONË.**